

**SHPALLJE PËR PJESËMARRJE
NË PROGRAMIN
“PUNËSIMI I PROFESIONISTËVE TË RINJ NË SHOQËRINË “ALBPETROL” SH.A”
2025**

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, nenit 18 të Statutit të Shoqërisë “Albpetrol” sha, dhe në zbatim të vendimit nr.16, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 19.12.2024, “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol Sh.A., 2025”, Rregullores për Programin “Punësimi i profesionistëve të rinj në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A”, miratuar me vendimin nr. 8, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 02.05.2024, shoqëria “Albpetrol” Sh.A shpall aplikimet për pjesëmarrje në Programin e Punësimit, 2024, për profesionistët e rinj.

Programin e Punësimit, 2025, është i hapur për profesionistët e rinj të diplomuar në programet e studimit në Qendrat e Prodhimit, si më poshtë:

Nr.	Dega	Specialiteti	Kuotat	Qendra e Prodhimit të Naftës		
				Fier	Kuçovë	Gorisht
1	Inxhinieri	Naftë / Naftë dhe Gazi / Naftë, Gazi dhe Uji;	17	10	5	2
2	Inxhinieri	Gjeologjike / Gjeologji Inxhinierike dhe Hidroenergji				
3	Inxhinieri	Gjeoinformatikë / Informatikë	1			
4	Inxhinieri	Mjedis/Gjeomjedis	1			
5	Inxhinieri	Mekanike/Elektrike/Mekatronike	1			

Afati për dorëzimin e dokumenteve 15.6.2025.

KRITERET PËR APLIKIM

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

- Të kenë përfunduar studimet në programet e studimit të përfshira në këtë shpallje;
- Të zotërojnë diplomë të nivelit bachelor / master;
- Të mos kenë qenë të punësuar më parë (të jenë pa eksperiencë pune).
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim (CV) i plotësuar në përputhje me dokumentin tip (Europass);
- Kopje të diplomës (në rastin e diplomës së nivelit master, të përfshihet edhe diploma e nivelit bachelor), shoqëruar me listën e notave dhe suplementin e diplomës. Diploma e

marrë jashtë Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet me njehsimin e saj nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

- c. Kopje të letërnjoftimit (ID);
- d. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore; Në rastin e kualifikimit, në përfundim të procedurës, paraqet vërtetim të gjendjes gjyqësore.
- f. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.;

*** Dokumentet e mësipërme të ngarkohen online **vetëm në format pdf**.

*** Mungesa e çdo dokumenti të kërkuar përbën arsye për skualifikimin e kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të sipërcituara, do të bëhen **online**, nëpërmjet adresës elektronike zyrtare të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A info@albpetrol.al **deri më datë 15.6.2025**.

SHPALLJA E REZULTATEVE DHE AFATET

Më datë **20.6.2025**, shpallet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret e posaçme për pjesëmarrje në Programin e Punësimit (faza e vlerësimit të dokumentacionit).

Më datë **26.06.2025**, do të organizohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë e kandidatëve të kualifikuar në fazën e vlerësimit të dokumentacionit.

Testimi me shkrim:

Vendi: Shkolla e mesme e përgjithshme “Zhani Ciko”, Patos.

Data: **26.6.2025**

Ora: 10:00.

Intervista me gojë:

Vendi: Salla e mbledhjeve e godinës së administratës qendrore të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A

Data: **26.6.2025**

Ora: Pas organizimit të testimit me shkrim

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohuritë e marra në programin e studimit, për të cilin ka aplikuar, dhe në praktikat mësimore e profesionale gjatë studimeve;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar,

- Njohuritë mbi Statutin e Shoqërisë “Albpetrol” sha;
- Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë;
- Kontratën Kolektive të Punës në shoqërinë “Albpetrol” Sh.a

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Vlerësimin për testimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës/profilin për të cilin kanë aplikuar;
- b. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Më datë **30.06.2025**, Shoqëria “Albpetrol” Sh.A do të shpallë në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve fitues në Programin e Punësimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga shoqëria “Albpetrol” Sh.A, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A